

Znj. Marjola Llanaj ka mbaruar studimet e larta të nivelit “Master Shkencor” në Fakultetin Ekonomik, në profilin “Administrim Biznesi” si dhe studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës.

Prej vitit 1999, znj.Llanaj ka ushtruar detyrën e inspektorese së lartë dhe drejtuese grupi auditimesh në Kontrollin e Lartë të Shtetit me fokus kontrollin ekonomiko-financiar dhe ligjshmërinë, për institucionet e larta qendrore, projektet me financim të huaj si dhe auditimin e aseteve dhe mjedisit.

Aktualisht është në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm.

Përgjatë karrierës së saj 20 vjeçare si audituese e lartë dhe kryeaudituese në Kontrollin e Lartë të Shtetit, Znj. Llanaj ka fituar një sërë kualifikimesh dhe certifikimesh nga institucione dhe organizata prestigjioze ndërkombëtare, përfshirë specializime dhe trajnime nga Zyra Kombëtare Britanike e Auditimit NAO, mbi metodologjinë e auditimit financiar, Gjykata Europiane e Audituesve për auditimin e fondeve të BE-së, Gjykata e Llogarive të Holandës mbi kontrollet e integritetit në Administratën Publike, Banka Botërore për auditimin e projekteve me financim të huaj, Qendra për Ekselencë në Financë në Slloveni, Gjykata e Llogarive Turqi, Norvegji, Portugali etj.

Certifikuar si trajnuese e oficerëve të prokurimit publik në Shqipëri nga trajnuesit e Bashkimit Evropian, pjesë e projektit “Mbështetje për sistemin e prokurimeve Publike në Shqipëri për njehsimin e legjislacionit të prokurimit publik shqiptar me legjislacionin e BE-së. Pjesëmarrëse në trajnimin mbi krizën ekonomike, zgjidhjet e mundshme të saj, në Gjykatën Evropiane të Llogarive, Luksemburg etj.

Në kuadër të angazhimeve ndërkombëtare, Znj. Llanaj ka qenë anëtare dhe përfaqësuese e KLSH-së në Task Forcën mbi auditimin e bashkive të Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI) si dhe pjesë e grupeve të punës dhe konferencave të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit INTOSAI, mbi proceset e-learning për implementimin e standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSA si dhe ka qenë pjesëmarrëse në kursin e-Learning organizuar nga IDI “Implementing Performanc Audit ISSAI-s’.